



VENDIM PËR HEQJEN E ANKESËS NGA LISTA

Data e miratimit: 10 nëntor 2014

Numri i lëndës: 2014-21

Shefki Hyseni

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtar ligjor
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 21 mars 2014.

2. Më 24 shtator 2014, Sekretariati i Panelit i ka dërguar një letër ankuesit, ku i ka kërkuar atij që të ofronte informacion shtesë rreth lëndës, në veçanti të siguroj ndonjë dokument që mendohet të jetë i rëndësishme për ankesën. Z. Hyseni nuk e ka bërë atë.
3. Më 15 tetor 2014, Paneli edhe një herë ka kërkuar nga ankuesi të siguronte dokumentet e kërkuara dhe ka njoftuar atë se nëse nuk i përgjigjet letrës, Paneli mund të konsideroj se ankuesi nuk ka ndërmend ta vazhdoj ankesën e tij dhe kështu mund ta heq atë nga lista e lëndëve.
4. Ankuesi nuk ka arritur t'i përgjigjet kërkesave të Panelit apo ta kontaktoj Panelin brenda afatit kohor të sugjeruar.

II. FAKTET

5. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmbliidhen si më poshtë:
6. Ankuesi pohon se ishte mbajtur në paraburgim për dhjetë muaj, pa ndonjë bazë ligjore apo arsyetim.
7. Duket se procedura penale kundër tij janë të pazgjidhura pranë Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
8. Megjithatë, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

III. ANKESAT

9. Pa u thirrur në ndonjë dispozitë të caktuara të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se të drejtat e tij janë shkelur. Duket se ai ankohet në lidhje me joligjshmërinë e paraburgimit të tij dhe mungesën e kujdesit të duhur mjekësor në një qendër paraburgimi.

IV. LIGJI

10. Sipas rregullës 29 e *tutje*, paragrafi 1 i rregullores së vet të punës, Paneli mundet që në çdo fazë të procedurës të vendos ta heq ndonjë ankesë nga lista e lëndëve, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se ankuesi nuk ka qëllim ta vazhdoj ankesën e tij/saj.
11. Pasi ankuesi nuk iu është përgjigjur kërkesave të vazhdueshme të Panelit për informata, duket se ankuesi ka humbur interesimin për vazhdimin e ankesës së tij. Si rrjedhojë dhe në mungesë të një treguesi të ndonjë shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut (shih rregullën 29 e *tutje*, paragrafin 2 të rregullores së punës), Paneli ka

konstatuar se nuk do të jetë e arsyeshme në këto rrethana të vazhdohet shqyrtimi i kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

vendos ta heq këtë ankese nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 e *tutje*, paragrafin 1(a) të rregullores së punës.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese